



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 63.11 106.2 dhe 117.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.11.2009 nxjerri këtë:

URDHËRESË PËR QNR-në

**Për Rinumërimin e Fletëvotimeve në Vendvotimet e caktuara sipas
Vendimeve/Udhëzimeve të KZAP-it**

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Udhëzon Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) që të bëjë rinumërimin e Fletëvotimeve për Zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit 2009 në pajtim me Vendimet përkatëse të KZAP-it të datës 21.11.2009 në Vendvotimet si në vijim:
 1. Vendvotimi nr. 2305D/03D në fshatin Firajë, Komuna e Shtërpçës (Vendimi A nr.144/2009);
 2. Vendvotimet nr. 2209E/01R, 02R në fshatin Pjetërshicë, Komuna e Shtimes; (Vendimi A nr.142/2009);
 3. Vendvotimet nr. 0213C/ 01,02,03 në fshatin Demjan, Komuna e Gjakovës (Vendimi A nr.87,92/2009);
 4. Vendvotimet nr. 1304E/01,02,03 në fshatin Shalë, Komuna e Lipjanit (Vendimi A nr.98/2009);
 5. Vendvotimet nr. 0219C/01,02,03,04 në fshatin Novosellë, Komuna e Gjakovës (Vendimi A nr.86,90/2009);
 6. Vendvotimet nr. 3032A/02 në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës (Vendimi A nr.96/2009);
 7. Vendvotimet nr. 0203X/01 në fshatin Bajram Curri, Komuna e Gjakovës (Vendimi A nr.114/2009);
- II. Obligohet QNR-ja që rezultatet përkatësisht raportin me vlerësimet lidhur me procesin e rinumërimit të Fletëvotimeve për secilin Vendvotim veç e veç nga pika I e këtij vendimi t'ia ofrojë Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (KZAP) përmes KQZ-së brenda datës 22.11.2009 deri në orën 16:00
- III. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve obligon QNR-në që në procesin e rinumërimit të Fletëvotimeve të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit si në pikën I t'i ftoj edhe vëzhguesit e subjekteve politike.
- IV. Kjo Urdhëresë hyn në fuqi me 21 nëntor 2009.

Prishtinë, 21.11.2009



Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve